

ABSTRAKT

Si rrjedhojë e luftës pushtuese të Rusisë kundër Ukrainës, janë shkelur në mënyrën më të vrazhdë normat dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht neni jetik 2.4 i K OKB, i cili në mënyrë të prerë e ndalon kërcënimin dhe përdorimin e forcës kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të çdo shteti. Gjithashtu si rrjedhojë e kësaj lufte FA të Rusisë gjatë operacioneve luftarake në Ukrainë janë duke i shkelur në mënyrë drastike ligjet dhe zakonet e luftës duke kryer krime lufte, krime kundër njerzimit dhe krime tjera të dënueshme nga e drejta ndërkombëtare (DN). Këto shkelje drastike të së DN inicuan një përgjigje të menjëhershme të institucioneve dhe mekanizmave ndërkombëtar si dhe shumicës absolute të shteteve të botës të cilat qoftë përmes sanksioneve dhe masave ndëshkuese të koordinuara ndërkombëtare kundër Rusisë, qoftë përmes përkrahjes dhe ndihmës së gjithanshme për Ukrainën si viktim e këtij pushtimi, janë involvuar dhe janë bërë pjesë dhe palë e këtij konflikti (luftë). Qëllimi i këtij punimi është të dëshmoj se në botën bashkëkohore shumica e subjekteve ndërkombëtare janë të interesuara që mosmarëveshjet eventuale midis tyre ti regullojnë sipas ligjit ndërkombëtar, në të kundërtën, çdo shkelje e ligjit ndërkombëtar do jetë me pasoja të rënda dhe kosto të lartë për shkelsin, i cili në këtë rast do të ballafaqohet me përgjigje të shpejtë dhe të fuqishme nga subjektet e së DN duke e sanksionuar, ndëshkuar dhe dëbuar nga mjedisi ndërkombëtar, deri sa të detyrohet që në marrëdhëniet me shtetet tjera ti përmbahet ligjit ndërkombëtar. Me këtë po i dërgohet një mesazh i qartë Rusisë dhe shkelsve tjerë eventuale se institucionet e së DN, subjektet ndërkombëtare nuk e pranojnë shkeljen e rendit juridik ndërkombëtar, nuk e njohin pushtimin e paligjshëm të UKR sot, dhe të asnjë shteti tjetër në të ardhmen.

Fjalët kyqe: e drejta ndërkombëtare, konflikti i armatosur, pushtimi i ukrainës, integriteti territorial.

